VENDIM
Nr.212, datë 11.3.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE

(Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 29.7.2020, nr. 1131, datë 24.12.2020; nr. 204, datë 25.3.2021; nr. 572, datë 6.10.2021; nr. 612, datë 20.10.2021; nr. 774, datë 15.12.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 3, shkronja "b", nënndarja "i", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore (projektimin, zbatimin e punimeve, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e këtyre objekteve) në vlerën, gjithsej, në masën 10 459 484 196 (dhjetë miliardë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH , përkatësisht:

i. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në vlerën, gjithsej, 4 347 753 223 (katër miliardë e treqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e tre) lekë;

ii. Bashkisë Tiranë, në vlerën, gjithsej 6 111 730 971 (gjashtë miliardë e njëqind e njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) lekë .

2. Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, të jetë në masën 5 001 173 797 (pesë miliardë e një milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 3 996 619 878 (tre miliardë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh pa TVSH;

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 1 004 553 919 (një miliard e katër milionë e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh pa TVSH.

2.1 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2021, të jetë në masën 4 886 106 464 (katër miliardë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet, në formën e transfertës së pakushtëzuar, fondi në masën prej 4 839 106 464 (katër miliardë e tetëqind e tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh pa TVSH;

b) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 47 000 000 (dyzet e shtatë milionë) lekësh pa TVSH.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim", të buxhetit të shtetit

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR